**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE**

# VENDIM

Nr. 6, Dt. 20.01.2009

***Per miratim ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit ujor, perroi i Rehoves (dege e lumit Kardhiq), per prodhim te energjise elektrike, nepermjet HEC-it ne Bashak, qe parashikohet te ndertohet ne vendin e quajtur Bashak, subjektit "Cobial" sh.p.k, Tirane.***

Ne zbatim te kerkesave te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet", kreu IV, te Vendimit te K.M-se nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreu II, te vendimit te K.K.U-it, nr.3, dt. 19.07.2002 "Per miratimin e rregullores te Sekretariatit Teknik, te K.K.U-it, te K.B.U-es dhe A.U. -it", si dhe udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E dhe relacionit te paraqitur nga A.U.B "Vjose", K.B.U "Vjose":

## VENDOSI:

1- Miratimin ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit ujor, Perroi i Rehoves, (dege e lumit Kardhiq), per prodhim te energjise elektrike, subjektit "Cobial" sh.p.k, Tirane, (nga kuota 258 m, ne kuoten 294.2 m, mbi nivelin e detit), nepermjet HEC-it qe parashikohet te ndertohet ne vendin e quajtur Bashak, me veper marrje ne vendin me koordinata:

X = 44 16 300 Y = 44 63 275 Z = 294.17 m

2- Sasia e ujit qe jepet ne perdorim $Q_{max} = 3\ m^3/sek$

3-Periudha e perdorimit te ujerave, do te jete gjate gjithe vitit, perjashto, periudhen nga 01.06. deri me 30.09, (te cdo viti), ku sasise te mesiperme do ti zbritet sasia 0.2 $m^3$/sek, qe do te perdoret per ujitje e kulturave bujqesore.

4-Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.

5-Ky vendim hyne ne fuqi pas procedurave te konkurimit, dhe miratimit te kontrates te koncesionit nga M.E.T.E dhe K.M-se dhe zbardhjes te lejes te perdorimit te ujit, per cdo veper nga K.B.U "Vjose".

**KRYETAR I K.B.U "VJOSE"**
**Hasan HALILI**

**PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"**
**Vezir METAJ**